



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 53/2020 regjistër (JR)  
Datë 24.11.2020

Nr. 30 i vendimit  
Datë 11.10.2021

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 11.10.2021, ditën e hënë, në orën 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerret Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa. Institucioni i Komisionerëve Publikë u përfaqësua në gjykim nga Komisioneri Publik Darjel Sina.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 286, datë 04.08.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Genti Shala, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2, F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 286, datë 04.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Genti Shala, prapësimet e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit, dëgjoi gjyqtaren relatore Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Genti Shala, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, të miratuar me ndryshimet kushtetuese me anë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, mbante detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, për shkak të këtij funksioni e parashikimeve ligjore, ai ka fituar statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio*.
2. Për subjektin e rivlerësimit Genti Shala, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në zbatim të neneve 33, 34 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
  - ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar<sup>1</sup>.
  - DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e kontrollit të figurës<sup>2</sup>, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
  - KLGj-ja, për subjektin e rivlerësimit Genti Shala, i ka përcjellë Komisionit një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për aftësitë profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 286, datë 04.08.2020, në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Genti Shala, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Këtë vendim, Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura lidhur me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat ka konkluduar se:

**3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:** *Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.*

**3.2 Për kontrollin e figurës:** *Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit Genti Shala ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

**3.3 Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional:** *[...] dërgimi për inspektim i njërës prej dosjeve të gjykuara nga subjekti, është i pamjaftueshëm për të arritur në vlerësimin e tij sipas shkronjës “b” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të*

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.02.2018.

<sup>2</sup> Me raportin nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.7.2019, të KDZH-së. DSIK-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 2.7.2020, ka dërguar raportin e përditësuar, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*} prot., datë 02.07.2020, të KDZH-së për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i cili nuk ndryshon konkluzionin e raportit të parë.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.11.2019, dërgohet raporti i Inspektoratit të KLGj-së.

*Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.*

3.4 Bazuar në konkluzionet e mësipërme, me vendimin nr. 286, datë 04.08.2020, Komisioni ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Shala, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.*

### **III. Shkaqet e ankimit**

4. Komisioneri Publik Florian Ballhysa<sup>4</sup> ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 286, datë 04.08.2020, të Komisionit, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Genti Shala.
5. Komisioneri Publik në ankim ka parashtruar se, pasi është njohur me rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit<sup>5</sup> (në vijim “ONM”) për ankimin e vendimit objekt gjykimi, nëpërmjet këtij mjeti procedural, në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 286/2020 të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të kriterit të pasurisë për të dhëna e informacione të cilat nuk janë hetuar nga Komisioni, referuar përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
6. Në ankim, Komisioneri Publik pretendon se:

6.1 *Nga aktet e administruara nga hetimi administrativ në Komision, rezulton se nga Regjistri Elektronik i Noterëve, i cili përmban, mes të tjerash, edhe të dhënat e akteve dhe veprimeve noteriale, në emër të subjektit të rivlerësimit, përcjellë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2019, është evidentuar një akt noterial me nr. {\*\*\*}, datë 17.08.2015, për shërbimin “kontratë huaje”, për të cilin rezulton se nuk është hetuar nga Komisioni. Komisioneri Publik pretendon se rezultatet e hetimit në lidhje me përmbajtjen e kësaj kontrate huaje, mund të ndikojnë në aftësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, në funksion të natyrës së marrëdhënies së huas, për vitin përkatës të lidhjes së kësaj kontrate.*

6.2 Komisioneri Publik, pasi është njohur me rekomandimin e ONM-së, e cila referon në përmbajtje të dhënat e marra prej një denoncimi, sipas të cilit pretendohet se subjekti i rivlerësimit disponon 15% aksione te shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me administrator z. L. L., ka pretenduar në ankim se ky denoncim, i paraqitur pas dhënies së vendimit objekt shqyrtimi, duhet shqyrtuar gjatë procedurës gjyqësore në Kolegj, pasi në të ngrihen dyshime për pasuri të padeklaruar e të fshehur

---

<sup>4</sup> Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65/2, të ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të ONM-së, më datë 11.11.2020, ka paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Genti Shala, bashkëlidhur të cilit është paraqitur edhe denoncimi anonim i datës 10.11.2020.

Për këtë rekomandim për paraqitje ankimi të ONM-së, Komisioneri Publik Darjel Sina, i cili, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c”, ka paraqitur një raport me shkrim, ku argumenton se rekomandimi i komisionit prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë, datë 11.11.2020, i administruar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, nuk i ndryshon bindjen e brendshme dhe provat e analizuara prej tij, gjatë hetimit të vendimit të Komisionit, duke mos ushtruar ai ankim.

Pasi është njohur me vendimin e Komisionerit Publik Darjel Sina, Komisioneri tjetër Publik Florian Ballhysa, duke u shprehur se ndan mendim të ndryshëm nga ai i Komisionerit Darjel Sina, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.11.2020, ka përcjellë pranë Komisionit ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 286, datë 08.04.2020, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Genti Shala.

<sup>5</sup> Të datës 10.11.2020.

të subjektit të rivlerësimit që, për shkak të momentit të paraqitjes së denoncimit, nuk ka qenë e mundur të hetohet.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

###### b) Legjitimimi i ankuesit

8. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 286, datë 04.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike. Përgjatë seancave gjyqësore, Komisioneri Publik, në mbështetje të ankimit të tij, ka kërkuar hetime lidhur me pretendimet e ngritura prej tij në ankim. Në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi u njoh me provat e administruara prej Kolegjit, Komisioneri Publik kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi. Subjekti i rivlerësimit Genti Shala, me parashtrimet e paraqitura në seancat gjyqësore publike të zhvilluara në Kolegj, ka prapësuar pretendimet e Komisionerit Publik duke analizuar në mbështetje të këtyre prapësimeve provat e paraqitura prej tij e të administruara prej Kolegjit përgjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.
10. Në përgjigje të kërtimeve të Komisionerit Publik, kërkit të subjektit të rivlerësimit dhe nevojës në dobi të gjykimit për hetime të mëtejshme lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45, 49 e 50, pika 2, germa “dh” e pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji çeli hetimin gjyqësor duke kryer veprimtarinë hetimore, e cila u përmbyll me marrjen me cilësinë e provës të akteve të dorëzuara në Kolegj nga vetë subjekti, si dhe atyre të marra nëpërmjet aksesit të drejtpërdrejtë të Kolegjit<sup>6</sup> nga burime/platforma elektronike shtetërore të hapura e të aksesueshme nga publiku. Kolegji vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të Komisionerit Publik, duke analizuar e çmuar të gjitha provat që gjenden në fashikullin e hetimit të krijuar nga Komisioni, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve.

<sup>6</sup> Nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit: [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al).

11. Kolegji vlerësoi përgjatë gjykimit edhe katër denoncime të paraqitura në Kolegj e të regjistruara përkatësisht nga shtetasi Y. L., regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.03.2021; nga shtetasi D. C., regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 06.04.2021; nga shtetasi H. M., regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} port., datë 30.06.2021 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 05.07.2021 dhe nga shtetasi A. S., regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.10.2021, të cilat nuk plotësonin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 e, si të tilla, u çmuan të pavlefshme për t'u hetuar më tej.

### **B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji**

12. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik se nga aktet e administruara prej hetimit administrativ në Komision, rezulton se nga të dhënat e Regjistrimit Elektronik të Noterëve, përcjellë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2019, rezulton se në këtë regjistër, në emër të subjektit të rivlerësimit, është evidentuar një akt noterial me nr. {\*\*\*}, datë 17.08.2015, për shërbimin “kontratë huaje”, për të cilin Komisioneri Publik pretendon se nuk është hetuar nga Komisioni dhe, si i tillë, ai duhet të jetë objekt i hetimit gjyqësor pasi rezultatet e hetimit në lidhje me përmbajtjen e kësaj kontrate, mund të ndikojnë në aftësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin përkatës të lidhjes së saj, Kolegji arsyeton si vijon.*

12.1 Nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, si dhe e akteve të fashikullit të krijuar përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni, rezulton se gjatë hetimit në Komision, është administruar shkresa e Ministrisë së Drejtësisë nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2019, tek e cila, në formë tabelare, jepen veprimet noteriale të kryera prej subjektit të rivlerësimit, nga ku rezulton i evidentuar edhe veprimi me përshkrimin “kont.hua”, nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 17.08.2015. Akti noterial që ka këto ekstremite, nuk rezulton të jetë administruar në fashikull, në funksion të hetimit administrativ të kryer prej Komisionit.

12.2 Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet parashtrimeve gjyqësore të datës 30.09.2021, shpjegoi para Kolegjit se ky akt noterial është një kontratë huapërdorje pasurie të luajtshme, me qëllim përdorimin prej subjektit, në cilësinë e huapërdorësit të automjetit objekt i kësaj kontrate, i cili është në pronësi të huadhënësit N. K.. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në këtë kontratë, huadhënësi deklaroi se automjetin e tij ia jep subjektit për ta përdorur brenda dhe jashtë territorit shqiptar, për një periudhë 10-ditore, nga data 17.08.2015.

Subjekti i rivlerësimit shpjegoi më tej se kjo kontratë huapërdorje është hartuar me qëllim përdorimin e automjetit për udhëtimin që kishte planifikuar së bashku me familjen për në Selanik, Greqi, në vitin 2015, dhe është përdorur vetëm një herë prej tij. Subjekti gjithashtu shpjegon se këtë udhëtim e ka deklaruar gjatë hetimit administrativ në Komision, dhe se të gjitha elementet e këtij udhëtimi i janë nënshtruar hetimit administrativ, pasi dalja jashtë vendit me këtë automjet është pasqyruar edhe në sistemin TIMS, si dhe i ka shpjeguar Komisionit raportin miqësor me shtetasin N. K. dhe faktin që nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit në raport me të.

12.3 Në seancën gjyqësore të datës 30.09.2021, subjekti i rivlerësimit paraqiti para Kolegjit në cilësinë e provës, aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.08.2015, të noteres publike O. K., i emërtuar “Kontratë huapërdorje pasurie të luajtshme automjet”.

12.4 Pasi u njoh me prapësimet e subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi, si dhe pasi administroi dhe vlerësoi në cilësinë e provës aktin noterial nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.08.2015, të noteres publike O. K., i emërtuar “Kontratë huapërdorje pasurie të luajtshme automjet”, Kolegji konstatoi se ky akt përfaqësonte në përmbajtje të tij kalimin e përkohshëm të të drejtave të përdorimit mbi një automjet në pronësi të huadhënësit N. K., te subjekti i rivlerësimit

si huamarrës. Të drejtat e kaluara te subjekti nëpërmjet kësaj kontrate, rezultuan se janë ushtruar efektivisht prej subjektit të rivlerësimit nëpërmjet përdorimit të këtij automjeti për një udhëtim të kryer jashtë vendit në gusht të vitit 2015 e që përkon me kohën e deklaruar në kontratë. Për këtë udhëtim dhe përdorimin e këtij automjeti, rezulton se subjekti ka dhënë përgjigje sipas pyetësorit të parë të drejtuar prej Komisionit në funksion të procesit të tij të rivlerësimit, si dhe është konfirmuar nga të dhënat zyrtare që gjenden në sistemin e të dhënave qeveritare TIMS.

12.5 Në referim të përmbajtjes së kontratës noteriale të përshkruar më lart, e cila është lidhur nga palët pa shpërblim, Kolegji nuk evidentoi asnjë të dhënë që të afektonte analizën financiare të njësisë familjare të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Komisioni për vitin 2015. Gjithashtu Kolegji, nga të dhënat e fletës së regjistrimit të noterëve të përcjellë nga Ministria e Drejtësisë, tek e cila jepen veprimet noteriale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, konstatoi se kjo kontratë, ndryshe nga kontratat e tjera, ka vlerën “0”, rrethanë kjo që konfirmon lidhjen e saj pa kundërshtëpërblim. Për pasojë, situata faktike dhe ligjore për këtë çështje mbetet ajo e përcaktuar prej Komisionit në vendimin e tij, e cila konfirmohet edhe nga gjykimi në Kolegji.

13. *Kolegji gjithashtu mori në shqyrtim edhe pretendimin e Komisionerit Publik për nevoja të kryerjes së hetimeve gjyqësore, lidhur me të dhënat e denoncimit të paraqitur pranë ONM-së pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, i cili për këtë shkak nuk ka mundur të hetohet prej Komisionit, tek i cili ngrihen pretendime se subjekti i rivlerësimit disponon 15% aksione te shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me administrator z. L. L., nga e cila lindin dyshime për pasuri të padeklaruar e të fshehur të subjektit të rivlerësimit.*

13.1 Nga analizimi i përmbajtjes së këtij denoncimi<sup>7</sup>, konstatohet se ai mban datën 10.11.2020, e cila i përkon periudhës pas dhënies së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi nr. 286, datë 04.08.2020, dhe rezulton të jetë paraqitur pranë ONM-së nga një shtetas anonim, i cili bashkëlidhur denoncimit ka paraqitur edhe ekstraktin historik të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, dhe foto të një ndërtese banimi.

13.2 Lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, në seancën gjyqësore në Kolegji të datës 30.09.2021, paraqiti kundërshtimet e tij në drejtim të përmbajtjes së këtij denoncimi, të cilin e konsideroi si një përpjekje e mënyrë abuzive për të vënë në dyshim besueshmërinë e tij në procesin e rivlerësimit dhe që gjithashtu tenton të zvarritë e të dëmtojë objektin e këtij procesi. Subjekti gjithashtu ka shpjeguar se përgjatë hetimit administrativ në Komision, ka rezultuar e qartë se marrëdhënia e tij e vetme me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, është vetëm marrëdhënia kontraktore për blerjen e banesës tek e cila subjekti dhe familja e tij banojnë aktualisht në Shkodër, duke shpjeguar gjithashtu se fotot e objektit që denoncuesi i ka bashkëlidhur ankimit, tregojnë pikërisht ndërtesën tek e cila ndodhet apartamenti në pronësi të tij. Subjekti në parashtrimet para Kolegjit, u shpreh se marrëdhënia e tij me shitësit e kësaj pasurie, L. L. e G. L., është hetuar prej Komisionit edhe për sa i përket ekzistencës së ndonjë konflikti interesi dhe nga hetimi nuk kanë rezultuar<sup>8</sup> të dhëna që e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e një situatë të mundshme të konfliktit të interesit me këta shtetas.

<sup>7</sup> Ky denoncim gjendet bashkëlidhur rekomandimit për ankim të ONM-së, i cili është publikuar në faqen zyrtare në internet të Komisionerëve Publikë: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/11/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-286-dat%C3%AB-4.8.2020.pdf>

<sup>8</sup> Në paragrafin 2.15 të vendimit të Komisionit nr. 286, datë 04.08.2020, shprehet se: “[...] 2.15.ii Ndërsa, në lidhje me ekzistencën e ndonjë trajtimi preferencial për shumën e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka vënë në dispozicion disa kontrata të ngjashme, të cilat sipas verifikimit konfirmojnë të njëjtën shumë të shpenzuar nga blerës të tjerë në të njëjtën godinë.

2.15.iii Po ashtu, për sa i përket ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm interesi të subjektit për shkak të funksionit të tij, me shitësit e kësaj pasurie, institucionet punëdhënëse të subjektit nuk kanë konfirmuar zhvillimin e ndonjë procesi gjyqësor me palë ndërgjyqëse shtetasit L. dhe G. L., si në cilësi individuale apo edhe të përfaqësuesit të shoqërisë ndërtimore. Njëkohësisht edhe subjekti ka vetëdeklaruar se nuk ka zhvilluar asnjë proces gjyqësor me

**13.3** Kolegji, në funksion të hetimit për verifikimin e informacionit të përcjellë me anë të denoncimit, mbështetur edhe në kërkimin e Komisionerit Publik për hetim, me vendim të ndërmjetëm të datës 30.09.2021, në zbatim të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi për të administruar në cilësinë e provës:

- ekstraktin historik të regjistrit tregtar të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, të gjeneruar më datë 28.09.2021 nga regjistri elektronik i Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të paraqitur në gjykim nga subjekti i rivlerësimit;
- aksesimin dhe administrimin e drejtpërdrejtë të të gjitha të dhënave dhe dokumenteve që gjenden të regjistruara dhe të publikuara në regjistrin tregtar elektronik të Qendrës Kombëtare të Biznesit për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në zbatim të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 50, pika 2, germa “dh” dhe pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.

**13.4** Kolegji<sup>9</sup>, bazuar në të dhënat e përfuara prej vetë adresimit të të dhënave zyrtare të faqes së internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, verifikoi dhe vlerësoi çdo të dhënë zyrtare të publikuar në këtë platformë elektronike, në zbatim të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, në të gjitha aktet e regjistruara nga momenti i themelimit e në vijim nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me Nipt {\*\*\*}. Në verifikim të sa më sipër, Kolegji nuk konstatoi asnjë të dhënë nga e cila të rezultonte se subjekti i rivlerësimit kishte aksione, marrëdhënie biznesi, përfaqësimi, konsulence, punësimi apo të ndonjë lloj tjetër me këtë shoqëri.

**13.5** Për sa u përket fotove bashkëlidhur denoncimit, duke qenë se përfaqësonin fotot e objektit në të cilin ndodhet apartamenti në pronësi të subjektit të rivlerësimit e për të cilin ai i është nënshtruar hetimit administrativ, ato nuk sollën për Kolegjin asnjë fakt ose rrethanë që mbështeste pretendimin e denoncimit, për pasojë u vlerësuan si jorelevante për hetimin gjyqësor.

**13.6** Bazuar në sa më sipër, si edhe në mungesë të çfarëdo adresimi tjetër për verifikim, të identifikuar qoftë nga denoncuesi në denoncimin objekt verifikimi, qoftë nga Komisioneri Publik, Kolegji vlerësoi se denoncimi i referuar nga Komisioneri Publik mbi të cilin ai kishte ngritur dyshimin për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk përmbante të dhëna që të mund të konfirmoheshin si të vërteta dhe që do të sillnin nevojën e vlerësimeve apo hetimeve të mëtejshme prej Kolegjit. Në konsideratë të këtyre fakteve dhe provave të administruara përgjatë gjykimit, Kolegji arriti në konkluzionin se denoncimi me anë të të cilit aludohej për pasuri të fshehur, rezultoi i pabazuar në fakte e prova dhe, si i tillë, nuk mund të ndikonte në procesin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

**14.** Në këto kushte, nga hetimi për verifikimin e shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik të analizuara si më lart, nuk rezultuan të dhëna të cilat do të ndryshonin vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në drejtim të vlerësimit e kontrollit të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit Genti Shala.

**15.** Në konkluzion të sa më sipër, duke mos konstatuar shkaqe që ndryshojnë vlerësimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Kolegji

---

*ta dhe se me shitësin e pasurisë është në marrëdhënie familjare, pasi vajza e xhaxhait të tij, shtetasin L. L., e ka bashkëshort”.*

<sup>9</sup> Nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, Kolegji aksesoi në të dhënat e regjistruara në platformën [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al) për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me Nipt {\*\*\*}, duke shkarkuar të gjitha dokumentet e aktet që gjendeshin të ngarkuara/regjistruara në regjistrin historik të kësaj shoqërie. Nga kontrolli i këtyre dokumenteve, të cilat ishin me natyrë administrative e financiare, nuk u konstatua asnjë e dhënë që subjekti i rivlerësimit apo familjarë të tij të figuronin si të punësuar apo përfaqësues të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

çmon se vendimi i Komisionit nr. 286, datë 04.08.2020, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Genti Shala, është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve e provave të administruara gjatë hetimit administrativ e në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, e për pasojë ai duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 286, datë 04.08.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Genti Shala.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 11.10.2021.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi – kundër*

#### **ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*



## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, votova kundër shumicës në shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Genti Shala [nr. 286, datë 04.08.2020]. Në vlerësimin tim, ky subjekt rivlerësimi nuk ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë dhe, për pasojë, duhet të ishte prezumuar në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Kjo bindje bazohet mbi probleme të qenësishme në arsyetimin me anën e të cilit Komisioni i Pavarur i Kualifikimit e konfirmoi këtë subjekt rivlerësimi në detyrë, disa prej të cilave u konstatuan dhe pasqyruan në rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), që mban datën 11.11.2020 [AC-Tir-1-18]<sup>10</sup>, mbi bazën e të cilit njëri nga komisionerët publikë ushtroi ankim<sup>11</sup>.
2. Nën dritën e jurisprudencës së mëparshme të Kolegjit, rekomandimi i ONM-së kërkonte që ankimi të përfshinte *të gjithë* vendimin e Komisionit, të paktën për sa i përket kriterit të kontrollit të pasurisë dhe vlerësimit profesional – përfshirë referimin e një çështjeje organit kompetent disiplinor. Po ashtu, rekomandimi sjell në vëmendje edhe nevojën për hetim të dy aspekteve specifike. Në përmbledhje, mbi bazën e “standardeve ligjore dhe financiare të konsoliduara nga Kolegji i Posaçëm i Apelit<sup>12</sup>” për sa i përket analizës financiare për vitet 2003-2016 dhe problemeve të konstatuara në lidhje me një apartament të blerë nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me sa konkluduar në hetimin shtesë dhe vlerësimin e kriterit profesional, rekomandimi çmon se premiset tregojnë që organet e rivlerësimit duhet konsiderojnë nevojën për të shkarkuar subjektin e rivlerësimit nga detyra. Ky qëndrim i vëzhguesve bazohet mbi zbatimin e kombinuar të parashikimeve të nenit 58, pika 1, germa “c” dhe të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Me fjalë të tjera, nëse do të zbatoheshin standardet e përcaktuara nga vetë Kolegji për situatën financiare dhe problemet që lidhen me një vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit Genti Shala do të duhet të shkarkohej, pasi me veprimet e tij kishte cenuar besimin e publikut.
3. Ankimi i ushtruar nga Komisioneri Publik mbi bazën e rekomandimit, ndër të tjera, referon nevojën për të hetuar dy aspektet shtesë të sjella në vëmendje nga rekomandimi<sup>13</sup>. Në ankim nuk rezulton të ketë analizë sipas nenit B, pika 3, germa “c” për refuzim të rekomandimit<sup>14</sup>. Në seancën publike të zhvilluar më 30.09.2021, në përgjigje të pyetjes sime në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, Komisioneri Publik nuk u shpreh për heqjen dorë apo përjashtimin e ndonjërit prej dy elementeve të rekomandimit, për të cilat iu drejtua pyetja nga të qenit pjesë e ankimit të ushtruar prej tij. Në këto kushte, në mungesë të një refuzimi të arsyetuar nga Komisioneri Publik për të ushtruar ankim mbi bazën e çfarë parashtrohet në rekomandim, prezumimi i vetëm që mbetet është që ankimi i Komisionerit mbështetur në rekomandimin e ONM-së, përthith arsyetimin e shtjelluar në të.

<sup>10</sup> [http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/11/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-286-dat%C3%AB-4.8.2020\\_.pdf](http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/11/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-286-dat%C3%AB-4.8.2020_.pdf).

<sup>11</sup> Komisioneri tjetër arsyetoi me shkrim mosushtimin e ankimit nga ana e tij, sipas përcaktimit të Kushtetutës në nenin B, paragrafi 3, germa “c”. Për referencë: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti-i-Komisionerit-Publik-z.-Darjel-Sina-dat%C3%AB-12.11.2020.pdf>.

<sup>12</sup> Faqe 2 e rekomandimit.

<sup>13</sup> Një denoncimi të ardhur në adresë të ONM-së në datën 10.11.2020, një ditë përpara rekomandimit, që lidhet me aksione/pronësi të një pjese të kapitalit të një shoqërie ndërtuese nga subjekti dhe një kontrate huaje të vitit 2015, pasqyruar në regjistrin noterial.

<sup>14</sup> Neni B, pika 3, germa “c” e Aneksit të Kushtetutës përcakton “[...] 3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra:[...] c) u jep komisionerëve publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim duke dhënë arsyet e refuzimit [...]”.

4. Në këto kushte, kam vlerësuar se trupi gjykues i Kolegjit do të duhet të vlerësonte problemet serioze në arsyetimin e Komisionit për sa i përket subjektit të rivlerësimit Genti Shala dhe në konkluzion, të merrej masa disiplinore e shkarkimit. Ndryshe nga shumica, vlerësoj se Kolegjit i është dhënë një rol aktiv në procesin e rivlerësimit nga dispozitat e nenit F, pika 3 e Kushtetutës për të kryer vlerësimin e provave. Ky vlerësim që bazohet në leximin harmonik të dispozitave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit, gjen zbatim edhe parë në tërësi me rolin që ka gjykata në një proces administrativ në mbrojtje të interesave publikë, sanksionuar nga neni 3, pika 2 e ligjit nr. 49/2012<sup>15</sup> dhe me parimin procedural civil sipas të cilit gjykata “bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët”, përcaktuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile.
5. Për pasojë, nga analiza e kriterit të vlerësimit pasuror për subjektin e rivlerësimit, gjej që nuk ka asnjë vend për dyshim që vlerësimi i kryer nga Komisioni, për të paktën njërën nga pasuritë që ka pasur në pronësi subjekti i rivlerësimit, një apartament me sipërfaqe 79 m<sup>2</sup>, blerë më 15.12.2000, në vlerën 19 mijë dollarë amerikanë, dhe që ka shërbyer si burim për një pasuri në pronësi në momentin e rivlerësimit, është në mënyrë flagrante në kundërshtim me përcaktimet e Kushtetutës dhe ligjit për të vendosur mbi bazën e dokumenteve. Komisioni haptazi *ka zgjedhur* të injorojë kontratat e administruara për këtë pasuri, nga të cilat subjekti rezultonte pronar i apartamentit për një periudhë disavjeçare, në favor të pretendimeve të tij kryekëput deklarative, se pavarësisht nga sa provojnë një kontratë shitblerjeje dhe një këmbimi, të dyja të rregullta, ky apartament i përkiste një së afërme të tij, e cila kishte nevojë për ndihmën e tij.
6. Kjo vendimmarrje e Komisionit bie ndesh me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, që përcaktojnë rregullat e hetimit dhe vlerësimit të fakteve mbi bazën e akteve zyrtare, ndër të tjera në nenin 45, pika 2, 49, pika 4 dhe 51 të ligjit nr. 84/2016, sikurse bie ndesh edhe me dispozitat e nenit 690 të Kodit Civil për sa i përket vlerës provuese të kontratave të lidhura rregullisht mes palëve<sup>16</sup>. Sjell në vëmendje se këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* me burim kursimet familjare të tij dhe të prindërve, blerë sipas kontratës në vitin 2000, shkëmbyer sipas një kontrate të dytë në vitin 2004, dhe shitur disa muaj pas këmbimit. Subjekti parashtrroi versionin sipas të cilit apartamenti nuk i përkiste atij dhe ishte një favor për një të afërme të nënës vetëm gjatë hetimit administrativ. Në këto kushte, arsyetimi i Komisionit, bazuar mbi pretendime tërësisht deklarative të subjektit në procesin e hetimit administrativ, që janë haptazi në kundërshtim me aktet ligjore si dhe deklaratën e pasurisë, bie ndesh me ligjin dhe jurisprudencën e Kolegjit dhe do duhet të ishte marrë në konsideratë nga shumica, qoftë edhe si shqetësim serioz i shkëljes së standardeve të barazisë së subjekteve përpara ligjit. Shumica e bazoi vendimmarrjen në një arsyetim formalist, duke mbështetur edhe konkluzionet përfundimtare të Komisionerit Publik, që përpos lënies në heshtje të problemeve themelore të nxjerra në pah nga rekomandimi, cedonte në logjikë.
7. Mangësitë në vlerësimin e Komisionerit, pasqyruar në fjalën përfundimtare dhe të pranuar nga shumica, bëhen të qarta nëse faktet cilësohen mbi bazën e natyrës së tyre dhe një arsyetimi tejet të thjeshtë logjik: nëse ankimi kërkonte vetëm hetimin e fakteve lehtësisht të verifikueshme, në çast, në faqen zyrtare në internet të Qendrës Kombëtare të Biznesit [QKB] për sa i përket pronësisë së aluduar të subjektit të rivlerësimit, ky institut [ankimi], e për pasojë angazhimi i Kolegjit në një proces gjyqësor publik, shkojnë në kufijtë e absurditetit. Arsyetimi i shumicës shpreh qartë këtë reduktim të procesit në një kontroll të faqes zyrtare në internet të QKB-së, në paragrafin 13.4, ndër të tjera.

---

<sup>15</sup> Ligji për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Neni 3, pika 2 parashikon që: “[2]. Gjykata administrative zbaton parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave e interesave të ligjshëm të personave privatë [...]”.

<sup>16</sup> “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj [...]”.

8. Në vijim të këtij arsyetimi, e gjej të pabazuar pretendimin e Komisionerit Publik – në bisedimet përfundimtare – që rekomandimi nënkuptonte vetëm që nënparagrafët e shënuar si “a” dhe “b” [në fund të faqes 2 të rekomandimit<sup>17</sup>] nuk ishin të mjaftueshëm për të konstatuar cenim të besimit të publikut, pasi ishin të varur nga hetimi mbi pronësinë e mundshme të subjektit në një shoqëri ndërtuese, hetim i cili kryhet në çast nga burime të hapura – faqja zyrtare e QKB-së. Komisioneri Publik e bazoi qëndrimin e tij në masë të madhe në shqetësimin për fshehje pasurie që do të duhet të përjashtohet nga një konsultim i thjeshtë i faqes zyrtare të QKB-së. Ky qëndrim është po ashtu i pabazuar, pasi nëse ishte fshehja themeli i shqetësimit mbi të cilin bazohej rekomandimi, ky i fundit do t’i referohej nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, që parashikon fshehjen e pasurisë si një ndër situatat ligjore. Përkundrazi, siç shtjellohet më sipër, rekomandimi konstaton rrethana që mund të shoqërohen me cenim të besimit të publikut, një koncept i pavarur, që parashikohet në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
9. E vetmja arsye për të cilën bën kuptim logjik ushtrimi i ankimit, në zbatim të parimit të barazisë së subjekteve përpara ligjit, objektivitetit e proporcionalitetit, ishte analiza e vendimit të Komisionit për mangësitë flagrante të konstatuara në vlerësimin e kriterit pasuror dhe transferimin e një çështjeje me natyrë disiplinore në kundërshtim të hapur me përcaktimin specifik të nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Nga analiza e vlerësimit të kriterit pasuror, subjekti i rivlerësimit rezultonte me balancë negative financiare për të krijuar me burime të ligjshme, minimalisht apartamentin prej 79 m<sup>2</sup> në vitin 2000, në vlerën 19 mijë dollarë amerikanë, dhe me pamundësi financiare të tjera në vlera të konsiderueshme, të cilat së bashku me balancën negative të vitit 2000, krijojnë një fotografi të qartë që subjekti nuk arrinte nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
10. Vlerësoj që subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut edhe me mungesën e seriozitetit në deklaratimet e tij në kohë të ndryshme, në të cilat ka vend për konstatim të deklaratimeve të pavërteta. Sjell në vëmendje që, duke krahasuar tri qasjet e ndryshme të subjektit ndër vite, konkretisht për pasurinë e përmendur më sipër, subjekti tregon mungesë sinqeriteti. Konkretisht, ndërsa në deklaratën e pasurisë [vetting] subjekti ka deklaruar tri veprime juridike të rregullta të kryera me apartamentin e blerë nga {\*\*\*} më datë 15.12.2000, shkëmbimin dhe më pas shitjen brenda harkut kohor 4-vjeçar – veprime të padeklaruara në deklaratimet periodike vjetore përkatëse, në procesin e hetimit administrativ, ka sjellë një skenar të favorshëm, për të evituar kushtet e mungesës së burimeve financiare në vlerën 19 mijë dollarë amerikanë në momentin e blerjes.
11. Më tej, kam votuar kundër shumicës edhe duke pasur parasysh disponimin në vendimin e Komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale për sa i përket denoncimit të znj. D. Xh. në lidhje me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. {\*\*\*}, datë 10.07.2017 [marrë me shumicë votash]. Duke abstraguuar nga problematika e procedimit penal dhe shpjegimet e subjektit për vendimmarrjen mbi “bindjen e tij të brendshme”, Komisioni ka zgjidhur çështjen duke e përcjellë formalisht tek “organi i specializuar<sup>18</sup>” [i paspecifikuar] dhe mbi të gjitha, në kundërshtim të hapur me përcaktimet e nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të cilat kërkojnë të konstatohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore ose shkaqe që duheshin marrë parasysh gjatë vlerësimit të tij periodik<sup>19</sup>, si kusht për transferimin e çështjes organit kompetent për inspektim.

---

<sup>17</sup> Nën-pikat “a” dhe “b” të seksionit 2, faqja 2 e rekomandimit, sjellin në vëmendje standardet e vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit lidhur me analizën financiare për vitet 2003-2016 dhe apartamentin e blerë nga {\*\*\*} ShPK me sipërfaqe 79 m<sup>2</sup>, zbatimin korrekt i të cilave mund të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. Shih: [http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/11/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-286-dat%C3%AB-4.8.2020\\_.pdf](http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/11/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-286-dat%C3%AB-4.8.2020_.pdf).

<sup>18</sup> Shih faqen 47 të vendimit të Komisionit: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/10/Vendim-Genti-Shala-1.pdf>.

<sup>19</sup> Neni 50, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 përcakton që: “[...] 4. Pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në

12. Nëse në zbatim të ligjit, Komisioni do të kishte analizuar veprimet dhe arsyetimin e subjektit të rivlerësimit, do të duhet të ishte shprehur nëse kishte vend për shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore. Nëse Komisioni do të shkonte përtej citimit literal të çdo shpjegimi të subjektit, duke kryer qoftë edhe një analizë të shkurtër të vetën, vendimmarrja e Komisionit mund të kishte përmbushur kriteret e dispozitave ligjore të sipërcituara, duke kryer me këtë rast edhe detyrën për të qenë transparentë në vendimmarrje. Nga ana tjetër, heshtja e Komisionit, në shkelje të detyrimit të shprehur ligjor, në përgjigje të një denoncimi nga publiku që në parim ngre automatikisht shqetësime në funksion të cenimit të besimit të publikut, do të duhet të ishte marrë në konsideratë nga Kolegji së bashku me faktorët e tjerë. Nga kjo analizë dhe çështjet e tjera të shtjelluara më sipër, do të ishte e pamundur të vendosej konfirmimi i subjektit të rivlerësimit në detyrë.
13. Për të gjitha këto arsye, votova kundër lënies në fuqi të vendimit të Komisionit me nr. 286, datë 4.08.2020. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e kontrollit të pasurisë dhe ka cenuar edhe besimin e publikut. Në vlerësim tërësor, ai do të duhet të ishte shkarkuar nga detyra mbi bazën e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

## **GJYQTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

---

*rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim [...]”.*